

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

DREJTORIA E SHËRBIMEVE FINANCIARE E TË ARDHURAVE VENDORE

ZYRA E NDIHMËS EKONOMIKE

Nr. 283 Prot.

Belsh më 20.06.2025

PROJEKT-VENDIM

Për propozim për dhënien e Ndihmës Ekonomike për periudhën 01.05.2025 - 31.05.2025

Bazuar në nenin 21 të ligjit nr 9355, datë 10.03.2005, i ndryshuar me Nr 57/2019 "Për ndihmën ekonomike dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar i cili parashikon që "Këshilli i Bashkisë Belsh ka të drejtë të miratojë kritere specifike për dhënien e ndihmës ekonomike me fondet e buxhetit vendor, dhe deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike për familjet me më shumë pjestarë ose familjet në nevojë "Zyra e ndihmës ekonomike bazuar dhe në verifikimet e bëra nga ana jonë **propozojmë dhe konkludojmë** të përfitojnë ndihmë ekonomike për muajin **MAJ 2025 për Bashkinë**, me një fond për 27 familje, një fond prej 95170 lekë.

Fondi i Bashkisë për familjet në nevojë.

Lista e familjeve të cilat ne propozojmë të përfitojnë ndihmë ekonomike janë familje ekstremisht të varfëra dhe nuk janë përzgjedhur për të përfituar nga sistemi pilot i NE për shkak të sistemit të ri të pikëzimit.

PËRGJEGJËSE NE

Rexhina BLLOKU

KRYETAR I BASHKISË

Arif TAFANI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Mustafa CARÇIU



Bashkia BELSH

...a e borderos MAJ 2025 Projekt-Vendimit në total të familjeve të propozuara për të përfituar me 6% e fondit të bllok-ndihmës për periudhën **1-31.05.2025**

Nr	Njësia Administrative	Numri familjeve	Fondi
1	Belsh	15	44555
2	Grekan	8	29273
3	Kajan	3	18196
4	Rrasë	1	3146
5	Fierzë	0	0
	Totali	27	95170

PËRGJEGJËSE NE

Rexhina BLOKU



KRYETAR I BASHKISË

Arif TAFANI

NË MUNGESË DHE ME UROHËR

SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Mustafa ÇARÇIT



AGESA E PERSONAVE QË PAGUIHEN NË SKEMËN E 6 % PËR MUAJIN MAJ 2025

	Emri i Aplikantit	Admin parave	NID Admin parave	Vlera e përllogaritur për fondin 6%	Kompensim i Energjisë	Totali	Firma
1	Shqipe Ali Abazi	Shqipe Ali Abazi	H357100110	2178.00	1288.00	3466.00	
2	Kujtim Ramazan Ahmeti	Hamide Xhevit Ahmeti	G76208004L	1525.00		1525.00	
3	Edlira Ferit Muça	Edlira Ferit Muça	H85202013D	1525.00		1525.00	
4	Jeta Xhevit Sina	Jeta Xhevit Sina	H05728210N	1525.00		1525.00	
5	Yllka Iljas Braho	Yllka Iljas Braho	I65202001C	7920.00		7920.00	
6	Liljana Zylyf Dervishi	Liljana Zylyf Dervishi	G65820022P	2178.00		2178.00	
7	Manushaq e Veiz Uruçi	Manushaqe Veiz Uruçi	I25511012V	7920.00		7920.00	
8	Marsida Shefqet Zekthi	Marsida Shefqet Zekthi	J06124010N	1980.00		1980.00	
9	Lumturi Ramazan Ahmeti	Lumturi Ramazan Ahmeti	H65621010P	2178.00		2178.00	
10	Marjeta Bexhet Reka	Marjeta Bexhet Reka	H15804006S	2178.00	1288.00	3466.00	
11	Ruzhdi Shyqyri Bali	Marjeta Bajram Bali	H05203007C	2178.00	1288.00	3466.00	
12	Jemine Shefqet Kasa	Jemine Shefqet Kasa	G75813008P	1525.00		1525.00	
13	Ferit Beqir Sina	Nafije Sali Sina	G65628009 W	1525.00		1525.00	
14	Besim Riza Sina	Zyhra Idriz Sina	F85525018E	2178.00		2178.00	
15	Sajde Ymer Paja	Sajde Ymer Paja	H05201011U	2178.00		2178.00	
16	Haxhi Ali Qypi	Fiqirete Sheme Qypi	G45213013H	1525.00		1525.00	

	Arjana Ramazani Hersin Skënderi	Ardiana Ramazan Skënderi	H15531094H	3703.00	1288.00	4991.00	
18	Anxhela Shefqet Senia	Anxhela Shefqet Senia	J66104014U	5940.00		5940.00	
19	Dashurie Petrir Sinani	Dashurie Petrir Sinani	G65827050J	2178.00		2178.00	
20	Tajar Hysen Bezati	Kadrije Shefqet Bezati	G16204004I	2178.00		2178.00	
21	Fatmir Aqif Madhi	Fatmir Aqif Madhi	G41229010J	2178.00		2178.00	
22	Ismail Sheme Kurani	Shefike Vesel Kurani	G05826105J	3703.00	640.00	4343.00	
23	Rajmonda Ardjan Rusta	Rajmonda Ardjan Rusta	J55202010B	5940.00		5940.00	
24	Florenc Ali Elezi	Zamira Rushan Elezi	I26103008M	6316.00		6316.00	
25	Sonila Yzeir Koçiu	Sonila Yzeir Koçiu	J85221010H	5940.00		5940.00	
26	Kristina Bajram Skënderi	Kristina Bajrami Skënderi	J95627010E	5940.00		5940.00	
27	Manushaq e Rrap Elezi	Manushaqe Rrap Elezi	G45125015L	3146.00		3146.00	
27				89378.00	5792.00	95170.00	

Përgjegjëse NE
Rexhina BLLOKU



Kryetari i Bashkisë
Arif TAFANI
NË MUNGESË DHE ME URDHËR
SEKRETARI PËRGJITHSHËM
Mustafa ÇARÇIU



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

BASHKIA BELSH

DREJTORIA E SHËRBIMEVE FINANCIARE E TË ARDHURAVE VENDORE

ZYRA E NDIHMËS EKONOMIKE

Nr. ____ Prot .

Belsh më ____ . ____ .2025

RELACION DREJTUAR KESHILLIT BASHKIAK .

Për miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar (6%) për ndihmën ekonomike.

Të nderuar anëtarë të këshillit bashkiak,

Referuar ligjit Nr. 139/2015, "Për vetqeverisjen vendore", neni 21 të Ligjit Nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 597 datë 04.09.2019 " Përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", kreu IV , pika 1 citon:

"Këshilli Bashkiak miraton në fillim të vitit kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese për ndihmë ekonomike, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike. "

Kerkojme që Këshillit Bashkiak të miratojë kete Projekt -vendim mbi kriteret e përfitimit të fondi 6% të sjellë nga zyra jonë.

Faleminderit për bashkepunimin!

PËRGJEGJËSE NE:

Rexhina BLOKU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

DREJTORIA E SHËRBIMEVE FINANCIARE E TË ARDHURAVE VENDORE
ZYRA E NDIHMËS EKONOMIKE

Nr. ____ Prot .

Belsh më ____ . ____ .2025

RELACION DREJTUAR KESHILLIT BASHKIAK .

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së nënve 12, pikat 1,4,5 të ligjit nr.9355 datë 10.03.2005 Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore ,të ndryshuar të Vendimit nr.57 datë 04.09.2019 të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike Kreu IV “Përdorimi i fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” ku thuhet se :Këshilli Bashkiak ka të drejtë të miratojë dhënie të ndihmës ekonomike për familjet që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit ,duke përdorur deri në 6% nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmë ekonomike.

Kërkojmë që Këshilli Bashkiak të miratojë këtë Projekt -vendim të sjellë nga zyra jonë.

Faleminderit për bashkëpunimin!

PËRGJEGJËSE NE:

Rexhina BLLOKU

Pr 2023, prot
05/06/2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më 02/06/2025

Nr. 5026

Lënda: Njoftim për vazhdimin e procedurave për dhënien e mandatit

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Belsh

Rruga "Hazi Dervishi", Belsh

Partisë Socialiste të Shqipërisë

Sheshi "Austria", Nr.91, Tiranë

Z. Aleksandër Avni Idrizi

Dragot, Koperative, Elbasan

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancën publike të datës 29.05.2025, mori në shqyrtim projekt-vendimin "Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Belsh, pas verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidatit, vendosi "Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Belsh, me kandidatin nga lista shumemërore e "Partisë Socialiste të Shqipërisë" z. Aleksandër Avni Idrizi.

Bashkëlidhur do të gjeni vendimin nr. 1332, datë 29.05.2025.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Sekretar i Përgjithshëm

(Në mungesë dhe me urdhër)

Majlinda ÇELMETA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 29.5.2025

Nr: 1332

Ora: 15:00


VENDIM

PËR

PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË BELSH, ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E "PARTISË SOCIALISTE TË
SHQIPËRISË", Z. ALEKSANDËR AVNI IDRIZI

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:



Me shkresën nr. 1362 prot., datë 16.04.2025, Këshilli i Bashkisë Belsh, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Aurela Bashkim Hysa, propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë".

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e "Partisë Socialiste të Shqipërisë" për Këshillin e Bashkisë Belsh, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 15, z. Aleksandër Avni Idrizi.

Me shkresën nr. 3737, prot., datë 05.05.2025, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Belsh, z. Aleksandër Avni Idrizi, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet



pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të subjektit "Partia Socialiste e Shqipërisë" ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër EL-PS-17058_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të z. Aleksandër Avni Idrizi, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja "b" dhe pika 3, shkronja "c", të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, me shkresën nr. 4116 prot., datë 09.05.2025, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 4117 prot., datë 09.05.2025, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për z. Aleksandër Avni Idrizi.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 915/1 prot., datë 21.05.2025, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar z. Aleksandër Avni Idrizi, ku konstatohet se kandidati ka ndryshuar emrin nga "SHKËLZEN" në "ALEKSANDËR".

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve, me shkresën nr. 7353/1 prot., datë 22.05.2025, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Aleksandër Avni Idrizi, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar z. Aleksandër Avni Idrizi në këshillin e Bashkisë Belsh, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreun V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"




VENDOS:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Belsh, me kandidatin nga lista shumëmemërore e "Partisë Socialiste të Shqipërisë", z. Aleksandër Avni Idrizi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Pr 2220 Prot

23/06/2025



REPUBLIKA E SHQIPËRI
BASHKIA BELSH

AGJENSIA E FUNKSIONEVE TE PATRANSFERUESHME

Nr. 653 Prot.

Belsh, më: 11/06/2025

PROJEKT - VENDIM

PËR HAPJEN E RRUGËS NË FSHATIN MARINEZ ME NR.PASURIE 323/4 DHE 323/3/1.

Në mbështetje të nenit 8, nenit 9, neni 20, neni 23 të ligjit të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar, VKM nr.886 date.03.11.2010 "Per miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkise 100%, të Qarkut Elbasanit".

PROPOZOJMË

1. Të miratohet me vendim të Keshilli Bashkiak hapja e rruges sipas Plan Rilevimit .
2. Për zbatimin e këtij projekt-vendimi ngarkohet Drejtorja e Bujqesise.
3. Jufaleminderit!

Përgjegjës Bujqësisë

Aranit Duka

Konceptoi Bazën ligjore

Emanuela Qosja

Drejtor zhvillimit ekonomik-Bujqësor, Rini, Sport, Kulturë

Albert Hysa

DREJTOR I PERGJITHSHËM

ARSEN HYSA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH
AGJENSIA E FUNKSIONEVE TE PATRANSFERUESHME

Belsh, më: 14 / 06 / 2025

Lënda: RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK BELSH

Të nderuar këshilltarë!

Në mbështetje te projekt vendimit "Përhapjen e një rruge në pronen me nr.pasurie 323/4 dhe 323/3/1 në Fshatin Marinez,Bashkia Belsh"

1. Përmbajtja e projektvendimit

Duke marrë në konsideratë kërkesen e paraqitur nga Znj.Verushe Kurtesi në datë 19.03.2025, me nr.255prot.,per hapjen e një rruge në fshatin Marinez,për zgjidhjen e situates e cila është e nevojshme për akses në pronen private me nr.pasurie 323/4 dhe 323/3/1 ku Znj.Verushe Kurtesi është bashkepronare, permes lejimit të kalimit nga nje sip. Toke të llojit shesh në pronesi të Bashkise Belsh , me nr. pasurie 323/5, për akses funksional në keto pasuri dhe shmangien e konflikteve në komunitet.

2. Baza ligjore e projektvendimit

Ky projekt vendim është i bazuar në disa dispozita ligjore, të cilat ndihmojnë në legjitimitetin dhe shmangien e konflikteve .

- **Ligji Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"**, i ndryshuar, që përcakton kompetencat e pushtetit vendor në menaxhimin e mbetjeve urbane, si dhe përgjegjësitë e Bashkive për sigurinë e shërbimeve të nevojshme për qytetarët.
- **VKM nr.886 date.03.11.2010** "Per miratimin e listës perfundimtare te pronave te paluajtshme publike,shteterore,qe transferohen ne pronësi ose ne përdorim te Bashkise Belsh, Te Qarkut Elbasanit".

3. Arsyet

Në bazë të kërkeses së bërë nga znj. Verushe Kurtesi në datë 22.05.2025 me nr.1855 prot., për hapjen e një rruge në fshatin Marinez (në pronësi të Bashkisë Belsh), e cila është e nevojshme për kalim në pronen me nr.pasurie 323/4 dhe 323/3/1 ,duke pasur konflikt të vazhdueshëm midis bashkëpronarëve. Pas shqyrtimit të kesaj kerkese dhe verifikimeve në terren nga grupi I punes ,është mbajtur një procesverbal në datën 09/05/2025 ,në të cilën është arritur një marreveshje për hapjen e rruges në pasurine nr.323/5,e cila është pronë publike në administrim të Bashkise Belsh ,palët janë dakordësuar që hapja e rrugës të realizohet dhe në këtë menyrë të lehtësojë aksesin për banorët dhe bashkëpronarët e pasurive përreth dhe do të beje të mundur shmangien e konflikteve që mund të ndodhin në të ardhmen midis palëve.

Për këtë arsye I propozohet Këshillit Bashkiak miratimi I projektvendimit ;Për hapjen e një rruge për kalimin në pronen me nr.pasurie 323/4 dhe 323/3/1 në Fshatin Marinez,Bashkia Belsh”.

Bashkangjitur do tëkeni:

1. Kërkesen e Znj VerusheKurtesi.
2. Procesverbal të verifikimit
3. Plani I rilevimit
4. Pamje/ foto nga terreni.

Përgjegjes Bujqesise

Aranit Duka

Konceptoi Bazën ligjore

Emanuela Qosja

Drejtor zhvillimit ekonomik-Bujqesor,Rini,Sport,Kulture

Albert Hysa

A

Zyrtarë konfliktuale
për mbrojtje

Nr. 402-Pr
dt. 26.05.2025

[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

ONE STOP SHOP

Nr. 1855-prot

Date 22/05/2025

KËRKESË

Une i nënshkruari/a Verushe Kurdesi banues/e në adresën Sopit Gjirokastër
Cel 069 768 9039 dhe dokument identifikimi ID nr. H 36104008R

Bazuar në: Kodin e Proçeduarave Administrative dhe ligjin nr. 119/2014 dt. 18.09.2014 Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare"

Kërkoj: Nga Bashkia Belësh në bazë të Proçesverbalit që u firmos në të he Palët m. marrëveshje të minadoni Krugës e cilës kalon në tokën shtet 325/5 dhe që do të kalojë ndërmjet dy pronave 323/3/1 dhe 323/4 ku jemi 7 bashkëpronar. Plani i Rivelimit është bazuar në bazë të ligjit dhe pas Miratimit kërkoj hapjen e Krugës vetëm nga bashkia. (Në asnjë mënyrë nuk mendoj vetgjyqesi)
Kërkesën time e bazoj në arsyetimin se:
Shqipëria, është shtet ligjor, dhe

Pas Miratimit kërkoj që Krugës të vendoset euri i babait tim të nënës Hasan Paja.

Bashkëlidhur do të gjeni dokumentat e poshtshënuara

1. Proçes verbal i mbajtur më datë 09/05/2025
2. Plan Rivelimi të Krugës nga Topografi Nazmi Musa.
3. ID
- 4.
- 5.

KËRKUESI Verushe Kurdesi

SPECIALISTI plerime Dugri

[Signature]

[Signature]

Proces verbal

I mbajtur sot më datë 09/05/2025 në
bazë të sqjdhjes së Kërkesës së znj. Verushë
kurtesi me nr. 255 Prot datë 19/03/2025 në
fshatin Marinës u arrit një Marrëveshje
për hapje rrugë për në pronën me numër
(323/4) Ku zonja është bashkëpronare.
(323/3/1)

Rruga u hap në pronën Shtet Shesh
me numër 323/5 (pronë e Bashkisë Belsh).
Bashkëngjitur do të jenë Fotot Ku u hap rruga.
Gjithashtu edhe një fragmentë harte të rrugës.
Unë do të ju parafes luadën nga topografia
(Verushë Kurtesi)

Grupi i punës.

Verushë Kurtesi
[Signature]

Ronaldo Jahja

ARANIT DUKA

[Signature]
Vjoll


[Signature]
Maj

Apostol Poje
[Signature]

7


HAPJE RRUGE E

NUMPI I PE MEVE


$$\begin{array}{l} X \ 4407397.032 \\ 2 \ Y \ 436435.7151 \end{array}$$


SHKRIM

Kode për teknologji dhe matjeve dhe përcaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Perfaqesues i Pronareve; K-Kufitare të Gjithe; KP-Kufitare të Pjesërisht; PB-Perfaqesues Bashkie; HK-Harta Kadastrale.









REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH

Nr. 1504 Prot.

Belsh, më: 27/05/2025

PROJEKT – VENDIM

**“PËR KALIMIN E SHERBIMIT TE PASTRIMIT NGA STRUKTURA E BASHKISE BELSH
TE GREEN SH.A**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.6(b), nenit 23, pika 10, nenit 33, pika 1(d) dhe nenit 54, pika (d) të ligjit të ligjit nr.139/2015 " Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar, Ligjit nr.9901/2008 "Per shoqëritë tregtare", kalimi i shërbimit te pastrimit te shoqëria "GREEN SH.A" bazuar ne VKB nr.59 date 02/12/2021 "Per miratimin e themelimit te shoqërisë tregtare "GREEN BELSH" si person juridik ne pronësi te Bashkise Belsh dhe miratimin e akteve te themelimit" synon te garantoje nje shërbim me te specializuar, te kontrolluar dhe te qëndrueshëm për komunitetin.

PROPOZOJME

1. Miratimin e kalimit te shërbimit te pastrimit te shoqëria Green Belsh sh.a.
2. Menaxhimi financiar dhe kontrolli do jete ne perputhje me legjislacion
3. Ky kalim përgjegjësie do të bëhet për arsye mirëadministrimi.

Ju faleminderit!

Përgjegjese Shërbimeve

Ramadan Cekrezi

Konceptoi Bazën ligjore

Sheje Ndoni

Drejtor I Shërbimeve

Andon Xhafa

KRYETARI I BASHKISË

ARIF TAFANI

(në mungesë dhe me urdhër)

Sekretari Përgjithshëm)

Mustafa CARÇIU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

Belsh, më: ____/____/2025

Lënda: RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK BELSH

Të nderuar këshilltarë!

Në mbështetje të projektvendimit "Per kalimin e shërbimit të pastrimit nga struktura e Bashkise te Shoqeria Green sh.a.

1. Përmbajtja e projektvendimit

Ky projektvendim ka për qëllim shërbimin e pastrimit dhe menaxhimin e mbetjeve urbane I cili perben nje nga funksionet kryesore te Bashkise sic parashikohet dhe te ligji nr 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore"

2. Baza ligjore e projektvendimit

Ky projektvendim është i bazuar në disa dispozita ligjore, të cilat ndihmojnë në legjitimitetin dhe nevojën për rinovimin e kontratës:

- **Ligji Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"**, i ndryshuar, që përcakton kompetencat e pushtetit vendor në menaxhimin e mbetjeve urbane, si dhe përgjegjësitë e Bashkive për sigurinë e shërbimeve të nevojshme për qytetarët.
- **Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"**, i ndryshuar, që parashikon rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet organeve publike dhe subjekteve të tjerë privatë që ofrojnë shërbime për organet publike.
- **Ligji Nr.10463, date 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"**

3. Arsytet e kalimit të Green sh.a

Kalimi I shërbimit të pastrimit është i nevojshëm për disa arsye të rëndësishme:

- **Vazhdueshmëria e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve:** Kontrata aktuale ka një afat deri më 18.06.2025. Pas kësaj date, është e domosdoshme që të behet kalimi për të garantuar vazhdimin e shërbimeve të pastrimit . Çdo ndërprerje e pastrimit mund të krijonte probleme me mbetjet dhe do të dëmtonte mjedisin dhe shëndetin publik.
- **Përmbushja e kërkesave ligjore dhe standardeve mjedisore:** Kalimi I shërbimit të pastrimit të green Sh.a është një shoqëri që kontribuon në përmbushjen e detyrimeve ligjore për menaxhimin e mbetjeve, si dhe në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit. Një sistem efikas i trajtimit të mbetjeve është thelbësor për mbrojtjen e natyrës dhe parandalimin e ndotjes.
- **Përmirësimi i kushteve të jetesës për qytetarët e Bashkisë Belsh:** Menaxhimi i duhur i struktures së pastrimit të mbetjeve është një element kyç për përmirësimin e kushteve të jetesës për qytetarët e Bashkisë Belsh. Kalimi I shërbimit të pastrimit të green SH.A do të ndihmojë në ruajtjen e higjienës dhe shëndetit publik në zonat e Bashkisë, duke siguruar trajtim adekuat të mbetjeve urbane dhe një ambient të pastër.

4. Përfitimet e këtij kalimi

- Rritja e cilesise se shërbimit dhe mbulueshmerine territoriale .
- Modernizimi I mjeteve dhe pajisjeve per mbledhjen dhe transportin e mjeteve.
- Zbatimi I nje modeli ekonomik te qendrueshem dhe te matshem financiarisht.

5. Forma e bashkepunimit dhe garancia ligjore

Shoqëria "Green" sh.a është subject I licensuar , me përvorje në fushën e menaxhimit të mbetjeve dhe ka kapacitet teknike, logjistike dhe njerzore për të përballuar shërbimin në territorin e Bashkisë Belsh.

Në përfundim, ky kalim përfaqëson një hap të domosdoshëm për rritjen e profesionalizmit në ofrimin e shërbimeve publike, në përputhje me parimet e decentralizimit, efikasitetit dhe transparencës. Propozimi është në interes të komunitetit, mjedisit.

Për këtë arsye I propozohet Këshillit Bashkiak miratimi I projektvendimit për kalimin e shërbimit të pastrimit pranë shoqërisë "Green sh.a".

Përgjegjëse Shërbimeve

Ramadan Cekrezi

Konceptoi Bazën ligjore

Sheje Ndoni

Drejtor I Shërbimeve

Andon Xhafa



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

DREJTORIA E SHËRBIMEVE FINANCËS E TË ARDHURAVE VENDORE
SEKTORI I TË ARDHURAVE VENDORE

Nr. 2153.prot

Belsh më. 18 . 06 .2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. — .Datë. 18 . 06 .2025

“Mbi problematikat e konstatuara në Vendimin e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Belsh Nr.57, datë 27.12.2024” sugjeruar nga “Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë, Drejtoria e Metodologjisë dhe Ligjore”

Në mbështetje të ligjit nr 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Per sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 132, datë 7.3.2018 për “Metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternative të detyrimit të taksës”, ndryshuar me VKM Nr. 144, datë 13.2.2020.

PROPOZOIM:

Të miratoi ndryshimet e bëra në Vendimin e Kshillit Bashkiak Belsh Nr, 57, datë 27.12.2024 për pikën. **A-Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, a) taksa mbi ndërtesat.**

Konceptoi:
P/Tatim-Taksave
Dijon Pepa

NË MUNGESË DHE ME URDIHËR
SEKRETAR I PËRGJITHËM
Mustafa Çarçiu



KRYETARI
Arif Tafani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

DREJTORIA E SHËRBIMEVE FINANCËS E TË ARDHURAVE VENDORE
SEKTORI I TË ARDHURAVE VENDORE

Nr. _____ .prot

Belsh më. _____ .2025

Relacion shpjegues:

Duke u nisur nga shkresa Nr.52/2 prot, datë 06.05.2025 nga “Drejtoria e Përgjithshme e Takses së Pasurisë, Drejtoria e Metodologjisë dhe Ligjore” protokolluar me tonën Nr.1702 prot date 08.05.2025 me lende “Mbi problematikat e konstatuara në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Belsh Nr.57. datë 27.12.2025”.

Problematikat e konstatuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Takses së Pasurisë, Drejtoria e Metodologjisë dhe Ligjore i kemi pasqyruar të ndryshuara në “Projekt Vendimin Për disa ndryshime në VKB-në Nr.57.datë 27.12.2024”.

Ju Faleminderit!

Konceptoi:
P/Tatim-Taksave
Ditjon Pepa

KUADRI I LIGJOR DHE NËN LIGJOR

Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, përbën ligjin bazë për reformat e decentralizimit të pushtetit vendor dhe përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njëjësive të qeverisjes vendore në drejtim të krijimit të taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.

Bazuar në Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, Ligjin 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" dhe Ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, në të ardhurat vendore përfshihen kryesisht:

- VKM nr. 132, datë 7.3.2018 për "Metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternative të detyrimit të taksës", ndryshuar me VKM Nr. 144, datë 13.2.2020.

☐ Taksa mbi pasurinë e paluajtshme;

➤ A-Taksa mbi pasurinë e paluajtshme.

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

➤ **Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:**

a) taksa mbi ndërtesat;

b) taksa mbi tokën bujqësore;

c) taksa mbi truallin;

1. Taksat llogariten si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e të drejtës së pronësisë.
2. Këshilli i Ministrave miraton metodologjinë për përcaktimin e vlerës së tatueshme të pasurisë së paluajtshme - ndërtesa.

Kategoritë minimale të bazës së taksës sipas klasifikimit dhe nivelet respektive të taksës mbi tokën bujqësore dhe mbi truallin (jo hapësirë publike), jepen përkatësisht, në anekset 1 dhe 2, që i bashkëngjiten këtij ligji dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Këshilli bashkiak vendos për nivelin e taksës, që do të zbatohet për çdo kategori minimale të bazës së taksës, të parashikuar në aneksin 1, në kufijtë plus-minus 30 për qind të nivelit tregues të taksës për kategorinë përkatëse.
4. Kur për një kategori minimale të bazës së taksës, këshilli bashkiak miraton nënkategori, ai, detyrimisht, përcakton edhe nivelin e taksës për secilën nënkategori. Niveli i taksës për çdo nënkategori është brenda kufijve të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni.
5. Këshilli bashkiak vendos për lehtësimin ose përjashtimin nga detyrimi për pagimin e taksave për:
 - a) personat, të cilët kanë të ardhura nën minimumin jetik, sipas kritereve të përcaktuara në nivel kombëtar;
 - b) taksapaguesin, pasuria e të cilit është dëmtuar nga veprimi i forcave madhore. Në këtë rast, lehtësimi ose përjashtimi është i perkohshëm dhe kohëzgjatja përcaktohet nga këshilli bashkiak, në raport me dëmin e shkaktuar deri në vlerën 75 për qind.

A/1 – Taksa mbi ndërtesat.

(shtuar një paragraf në pikën 1 me ligjin nr.9764, datë 9.7.2007, shtuar shkronja "ç" me ligjin nr.106/2013, datë 28.3.2013, shtuar një paragraf në pikën 1 me ligjin nr.181/2013, datë 28.12.2013, shtuar fjala e dytë në paragrafin e parë me ligjin nr.142/2015, datë 17.12.2015, ndryshuar plotësisht me ligjin nr.106, datë 30.11.2017, ndryshuar shkronja "ë" dhe shtuar shkronja "f" me ligjin nr.95/2018, datë 3.12.2018)

❖ Perkufizime:

Për qëllim të zbatimit të metodologjisë për përcaktimin e bazës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesë", termit e mëposhtëm kanë kuptimin si më poshtë vijon:

1. "Çmim vlerësues", njësi matëse e vlerës për metër katror të sipërfaqes së ndërtimit të pasurisë së paluajtshme. Ky çmim mund të jetë çmimi i tregut ose çmimi i vlerësuar i përcaktuar me këtë metodologji.
2. "Ndarje/nënndarje zonale", një rajon territorial brenda njësisë së vetëqeverisjes vendore me emër dhenumer kadastral unik. Këto ndarje/nënndarje paraqiten në parcela tokësore me kufij të përcaktuar, që i ndajnë ato nga njëra-tjetra.
3. "Ndërtesë": është objekti/objektet e ndërtuara mbi/nën sipërfaqen e tokës ose të lidhura me tokën dhe që përfaqëson një strukturë ndërtimore me një ose më shumë njësi pronësore, e cila është objekt i taksës mbi ndërtesën sipas përcaktimit të dhënë në ligj.
4. "Ndërtesë e papërfunduar", objekti ndërtimor në tërësi ose/edhe ajo pjesë e ndërtesës ekzistuese, për të cilin zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi, por që nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

5. "Njësi pronësore", ndërtesa ose pjesë e saj, e cila është në pronësi/përdorim të individit, të njëpersoni fizik apo të një personi juridik, dhe që është e ndarë ligjërisht nga pronat e tjera të pasurisë së paluajtshme "ndërtesë". Njësia pronësore mund të përdoret për qëllim banimi ose edhe për qëllim veprimtarie ekonomike etj.
6. "Ndarje e njësisë pronësore për banim", pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim banimi.
7. "Ndarje e njësisë pronësore për veprimtari ekonomike", pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim veprimtarie ekonomike.
8. "Përdorues", individ, personi fizik ose personi juridik, që ka në përdorim ndërtesën/njësinë pronësore për qëllime banimi, veprimtarie ekonomike apo për veprimtari joekonomike, pavarësisht nga fakti nëse kjo ndërtesë/njësi pronësore ka titull pronësie ose jo.
9. "Regjistër qendror i bazës së të dhënave të pasurisë së paluajtshme" (Kadastra fiskale), sistemi qendror i bazës së të dhënave, i cili shërben për hedhjen, përpunimin, korrektimin e të dhënave, të cilat lidhen me pasurinë e paluajtshme dhe që shërbejnë për efekt të llogaritjes së shumës së taksës së pasurisë së paluajtshme për t'u paguar nga çdo taksapagues. Ky regjistër ofron informacion për përdoruesit.
10. "Taksapagues", çdo individ, person fizik ose juridik, vendës ose i huaj, pronar apo përdorues i pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave. Detyrimin për pagimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme "ndërtesë" e kanë, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente të pronësisë, personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse të lëshuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore.
11. "Vlerë e pasurisë", vlera aktuale e pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore e njohur me dokumente ligjore ose vlera e përcaktuar me një nga metodat e përshkruara në këtë metodologji. Vlera e pasurisë është baza e taksueshme mbi të cilën aplikohet shkalla e taksës së pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore. Vlera e pasurisë llogaritet si shumëzim i çmimit për metër katror me sipërfaqen e ndërtesës/njësisë pronësore.
12. "Veprimtari ekonomike", çdo veprimtari e kryer nga prodhuesit, tregtarët, personat që furnizojnë mallra dhe shërbime, përfshirë veprimtaritë nxjerrëse, industriale, tregtare, të shërbimit, bujqësore dhe veprimtaritë profesionale. Veprimtari ekonomike konsiderohet, gjithashtu, shfrytëzimi i pasurisë së trupëzuar ose të patrupëzuar, me qëllim realizimin e të ardhurave me karakter të vazhdueshëm.

➤ **Taksa mbi ndërtesat;**

- a. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendës apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe.

- b. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.
- c. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përlllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
- d. Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.
- e. Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave.
- f. Përfshihen nga taksa mbi ndërtesat:

- a). pronat e shtetit dhe të njëjësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b). pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- c). ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- ç). banesat sociale në pronësi të bashkive;
- d). pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- dh). ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- e). strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”;
- ë). ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të pa aftë për punë;
- ff). ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- g). ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.

Baza e taksës

Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Këshilli i Ministrave, në bazë të vjetërsisë së ndërtesës, mund të specifikojë nënkategori përkatëse.

Shkalla e taksës

Llogaritja e shumës së taksës së ndërtesës/ njësisë pronësore

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke përdorur të dhënat e mbledhura për ndërtesën/njësinë pasurore, përcaktojnë bazën e taksës dhe llogarisin shumën e taksës vjetore të ndërtesës për t’u paguar nga çdo taksapagues. Baza e llogaritjes së taksës së ndërtesës është vlera e ndërtesës/njësisë

pronësore, përcaktuar me një nga metodat e parashikuara në këtë metodologji.

Për efekt të llogaritjes së taksës për ndërtesën/ njësi pronësore, baza e taksës shumëzohet me shkallën në përqindje të taksës së miratuar me ligj, sipas kategorive të ndërtesave, si më poshtë:

- a) 0,05%, për ndërtesën/njësine pronësore që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- b) 0,2%, për ndërtesën/njësine pronësore që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
- c) 30% e shkallës së taksës përkatëse, për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë, sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Çmimet mesatare referuese të shitblerjes së ndërtesave për Bashkinë Belsh është **35.000** leke/m²

Këshilli i Ministrave përcakton rregulla në lidhje me:

- a) natyrën dhe prioritetin e informacionit që do të përdoret në lidhje me përcaktimin e bazës së taksës mbi ndërtesat, në raste mospërputhjes të informacionit të marrë nga burime të ndryshme;
- b) prioritetin e të dhënave që do të përdoren në lidhje me vlerën e tatueshme.

1. Njësia e vetëqeverisjes vendore është autoriteti përgjegjës për administrimin e taksës mbi ndërtesat nën juridiksionin e saj, përmes ushtrimit të funksioneve të mëposhtme:

- a) mbledhjen dhe menaxhimin e informacioneve mbi ndërtesën për qëllime fiskale;
- b) përditësimin e të dhënave të regjistrit qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale);
- c) mbledhjen me forcë të detyrimeve të taksës mbi ndërtesën;
- ç) korrigjimin e të dhënave në lidhje me llogaritjen e taksës, në rastet e saktësimit të informacionit për sipërfaqen, vendndodhjen zonale, çmimet e tregut etj.;
- d) shqyrtimin e ankimit administrativ të taksapaguesve.

2. Taksa mbi ndërtesën, sipas dispozitave të këtij ligji, mund të mblidhet nëpërmjet agjentëve të taksave, të cilët kanë shtrirje territoriale, sistem elektronik të bazës së të dhënave e të gjenerimit të detyrimeve dhe që autorizohen me vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me legjisllacionin në fuqi për procedurat tatimore. Këshilli i Ministrave përcakton edhe masën e përfitimit të agjentit të autorizuar, mbi të ardhurat e arkëtuara nga taksa e ndërtesave.

3. Të ardhurat e mbledhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme derdhen për llogari të buxhetit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, dhe përdoren në përputhje me ligjin "Për financat e vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë."

❖ Metodologjia për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa"

1. Përcaktimi i çmimit vlerësues dhe i sipërfaqes së ndërtesës/njësisë pronësore
Përcaktimi i vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore bazohet mbi prioritetet e vlerësimit, duke ndjekur një radhë të caktuar. Baza e vlerësimit mbështetet te vetëdeklarimi, si një detyrim për çdo taksapagues, për të vijuar më tej edhe me metodat alternative, nëse vetëdeklarimi nuk bëhet, nuk është i saktë apo nuk disponohen të dhëna të plota për një vlerësim të drejtë të pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore, që duhet të

taksohet. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për efekt të përcaktimit të bazës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ndërtesë, ndjekin këtë radhë vlerësimi:

1.1. Vetëdeklarimi

Çdo taksapagues duhet të vetëdeklarojë të dhënat për pasurinë e tij të paluajtshme ndërtesë/ njësi pronësore, që ka në pronësi apo në përdorim. Vetëdeklarimi bëhet pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore apo çdo institucioni të autorizuar nga qeveria apo njësitë e vetëqeverisjes vendore, për të marrë dhe për të përpunuar informacionin e vetëdeklarimit të taksapaguesit, për qëllim të zbatimit të legjislacionit përkatës të taksës mbi pasurinë e paluajtshme.

Në rast se vlera e vetëdeklaruar nga taksapaguesi rezulton e ndryshme nga vlera e llogaritur me çmim e vlerësuar, të përcaktuar me këtë metodologji, si vlerë e bazës së taksës do të merret vlera më e lartë.

Në fazën fillestare të zbatimit të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, mund të merren në konsideratë dhe të përdoren të dhënat e siguruara nga institucione të autorizuar nga qeveria apo njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat shërbejnë për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme dhe përcaktimin e bazës së taksës.

1.2. Përcaktimi i çmimit të vlerësuar dhe i sipërfaqes së ndërtesës, bazuar në regjistrin e pasurive të paluajtshme të mbajtur nga zyrat vendore (ZVRPP)

Për përcaktimin e bazës së taksës për ndërtesën/njësinë pronësore, si referencë, në këtë rast, do të shërbejë vlera e përcaktuar nga rivlerësimi i pasurisë të regjistruar pranë ZVRPP-ve.

Nëse në informacionin e marrë nga ZVRPP-ja konstatohet se për ndërtesën/njësinë pronësore është kryer një transaksion shitblerjeje gjatë 3 viteve të fundit, atëherë si bazë e taksueshme do të merret vlera më e lartë midis transaksionit dhe vlerës të regjistruar në ZVRPP.

1.3. Përcaktimi i çmimit të vlerësuar sipas çmimeve mesatare të shitblerjes së ndërtesave/ njësive pronësore

Kur vlerësimi sipas pikave 1.1 dhe 1.2 më lart është i pamundur, çmimi i vlerësuar për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore do të korrespondojë me çmimin mesatar referues të ndërtesave që përdoren për qëllime banimi sipas qyteteve, të përcaktuara në aneksin 1 që i bashkëngjitet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Për nënkategorizime të ndërtesave, që nuk shërbejnë për banim, sipas qëllimit të përdorimit, zbatohen çmimet mesatare për metër katror sipërfaqe ndërtimi, të përcaktuara në aneksin 2 që i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Nëse çmimi për metër katror për banesë/njësi pronësore, i vënë në dispozicion nga ZVRPP-ja, dhe çmimet minimale fiskale janë të ndryshme, atëherë merret si çmim vlerësues ai çmim që ka vlerën më të lartë.

2. Vlera e pasurisë së paluajtshme "ndërtesë", referuar verifikimeve në terren

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me kompetencat e kuadrit ligjor në fuqi, kryejnë korrektime në regjistrin e bazës së të dhënave. Korrektimet kryhen bazuar në verifikimet periodike në terren për sipërfaqen e ndërtesës/ njësisë pronësore.

Verifikimi në terren shërben edhe për të regjistruar për herë të parë ndërtesa/njësi pronësore ose nënndarje të saj. Në këtë rast, njësitë e vetëqeverisjes vendore kërkojnë informacion nga burime zyrtare, nëse ka, për sipërfaqen e ndërtesës/njësisë pronësore apo nënndarjen dhe e krahasojnë me verifikimin e kryer. Nëse nuk sigurojnë informacione lidhur me sipërfaqen e ndërtesave të identifikuar, njësitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë vetëvlerësimin e ndërtesës/njësisë pronësore mbi sipërfaqen e verifikuar në terren.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas procedurave të përcaktuara në këtë metodologji, në çdo rast, pasi bëjnë vlerësimin e vlerës së pasurisë së paluajtshme, hedhin të dhënat në regjistrin e

bazës së të dhënave, për efekt të përcaktimit të bazës së taksës dhe llogaritjes së shumës së taksës për t'u paguar nga taksapaguesi.

2.1 Sipërfaqja e prezumuar

Nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njesisë pronësore, përdoren vlerat referuese për sipërfaqe, si më poshtë vijnë:

- a) 100 (njëqind) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim;
- b) 70 (shtatëdhjetë) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim, të privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", të ndryshuar.

Për ndërtesat e tjera, të cilat nuk shërbejnë për qëllime banimi, njësitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë verifikimin në terren, për të përcaktuar sipërfaqen dhe për të llogaritur bazën e taksës.

Kur gjatë verifikimeve në terren konstatohen dëmtime të ndërtesave për shkaqe të fatkeqësive natyrore (tërmet/zjarr/përmytje etj.), të cilat ndryshojnë vlerën e kësaj pasurie, njësia e vetëqeverisjes vendore, sipas rastit që i paraqitet, ngre një komision, i cili vlerëson dhe korrekton vlerën e ndërtesës. Vlerësimi bëhet sipas gjendjes fizike në të cilën paraqitet ndërtesa e dëmtuar.

3. Nënndarja zonale/nënzonale brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore
Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të miratojnë nënndarje zonale/nënzonale të territorit, brenda juridiksionit të tyre, për zbatimin e niveleve të shkallës së taksës brenda kufijve plus 30 (tridhjetë) për qind ose minus 30 (tridhjetë) për qind.

Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, jo më shpesh se një herë në vit, për banesat në njësitë administrative jashtë qytetit përkatës, të cilat iu bashkuan njësive të qeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 115/2014, mund të reduktojë çmimin mesatar referues të përcaktuar në aneksin 1. deri në masën minus 35 (tridhjetë e pesë) për qind, krahasuar me çmimin e zonës më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale.

4. Vlera e pasurisë së paluajtshme për ndërtesat e papërfunduara në shkelje të afatit të lejes së ndërtimit

Për ndërtesat e pajisura me leje ndërtimi, por që nuk kanë arritur të përfundojnë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi, përcaktimi i bazës së taksueshme bazohet mbi koston e parashikuar të ndërtimit, sipas lejes së ndërtimit të miratuar nga njësia përkatëse e vetëqeverisjes vendore apo KKT-ja. Në këtë rast, vlera e bazës së taksës së ndërtesës llogaritet për të gjithë ndërtesën, kur është një njësi e vetme dhe e destinuar për një qëllim të vetëm përdorimi, pavarësisht fazës në të cilën gjendet ndërtesa e papërfunduar. Baza e taksës së ndërtesës llogaritet në masën 30 (tridhjetë) për qind të shkallës së taksës të përcaktuar me ligj, shumëzuar me koston e ndërtimit të parashikuar në lejen e miratuar të ndërtimit.

5.Procedura e mbledhjes së informacionit nga verifikimi në terren

-Verifikimi në terren për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme bëhet, në çdo rast, me urdhër të titullarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse, në territorin e së cilës gjendet ndërtesa/njësia pronësore që do të vlerësohet.

-Kur taksapaguesi pengon punonjësit e njësisë së vetëqeverisjes vendore të ushtrojnë detyrën e tyre, sipas urdhrat të lëshuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore për këtë qëllim, ndaj tyre do të llogaritet taksa e plotë. Në këtë rast, sipërfaqet do të vlerësohen duke përdorur metodat alternative të vlerësimit, siç përcaktohet në këtë metodologji.

Nënkategori specifike ndërtesash dhe qëllimi i përdorimit

Nënkategorizimi i ndërtesave/njësi pronësore që nuk përdoren për banim, sipas qëllimit të përdorimit dhe të shfrytëzimit të tyre, përcaktohen në aneksin 2, bashkëngjitur këtij vendimi.

Nënkategoritë e ndërtesave/njësive pronësore, që shfrytëzohen për banim/strehim, jepen si më

poshtë:

1. Ndërtesa e cila u shërben njerëzve për nevoja themelore banimi, duke përfshirë shtëpitë, apartamentet, banesat dhe ndërtesat e ngjashme;
2. Garazhet e mbyllura;
3. Bodrumet;
4. Çdo ndërtesë tjetër e ngjashme, mbi apo nën tokë, që nuk përdoret apo shfrytëzohet për qëllime të tjera veç atij të banimit.

ANEKSI 1

ÇMIMET MESATARE REFERUESE PËR METËR KATROR SIPËRFAQE NDËRTIMI PËR VLERËSIMIN E VLERËS SË TAKSUESHME PËR BANESAT

Çmimet mesatare referuese të shitblerjes së:

- a) ndërtesave që përdoren për qëllim banimi, sipas qyteteve, për çdo bashki, sipas qarqeve.
 - a.1) Çmimet mesatare referuese të shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllim banimi, sipas qyteteve, për çdo bashki, sipas qarqeve (me përjashtim të Bashkisë Tiranë);
 - b) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për banim në njësitë administrative jashtë qytetit përkatës, të cilat iu bashkuan njërive të vetëqeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 115/2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", reduktohet deri në 35 (tridhjetë e pesë) për qind, krahasuar me çmimin e zonës më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale. Në zonat që përfshihen në Bashkinë Tiranë, ky reduktim është deri në 30 (tridhjetë) për qind krahasuar me çmimin e zonës më të afërt.
 - c) Për ndërtesat e privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", të ndryshuar, çmimi për metër katror është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit sipas zonave të tabelës, vetëm në rastin e shitjes së parë.

ANEKSI 2

ÇMIMET MESATARE REFERUESE PËR METËR KATROR SIPËRFAQE NDËRTIMI PËR VLERËSIMIN E VLERËS SË TAKSUESHME PËR NDËRTIME DHE AMBIENTE JO-BANIMI

- a) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari ekonomike tregtimi shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori përfshihen edhe njësitë tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhimi, tregtimi apo shërbimi me pakicë. Në zonat që përfshihen në Bashkinë Tiranë ky koeficient është 2 (dy) herë më i lartë.
- b) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.
- c) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ambiente parkim i hapur, pishinë e hapur, ambiente sportive të hapura, të tilla si: fusha futbollit, minifutbollit, basketbollit, volejbollit, tenisi, golfi, pista për gara të ndryshme sportive të atletikës, motorike, garave me kuaj e të tjera të ngjashme me to; porte dhe aeroporte të çdo kategorie, për të gjithë sipërfaqen e shtrirë që ato zënë, është 30 (tridhjetë) % e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve, ose sipas njërive administrative për Bashkinë Tiranë.
- ç) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, të tilla si: prodhim, përpunim apo magazinim të lëndëve të para, të gjysmëprodukteve apo të produkteve të gatshme industriale, si: fabrika, magazina, depo, silos, magazina frigoriferike të produkteve ushqimore (përjashtuar ato të njërive të tregtimit dhe të shërbimit), si dhe objektet e tjera të ngjashme me to, është 50 (pesëdhjetë) % e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse,

sipas qyteteve ose sipas njësive administrative për Bashkinë Tiranë.

Në këtë kategori përfshihen dhe ndërtesat që shërbejnë për veprimtari arsimore jopublike të çdo niveli, si dhe ambientet sportive të mbyllura, përfshirë dhe pishinat e mbyllura.

d) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori, apo veprimtari mbështetëse, si: grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale, është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, me përjashtim të përpunimit ushqimor.

dh) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimore për ndërtimet e reja regjistruar sipas lejes së përdorimit në ASHK, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të indeksohet me koeficientin 0.2 (zero pikë dy) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqes së apartamentit të banimit sipas listës së përcaktuar aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi, për 5 vitet e para pas regjistrimit të lejes së përdorimit në ASHK.

Çmimet mesatare referuese të shitblerjes së ndërtesave për Bashkinë Belsh është 35.000 leke/m².

✓ **Ndarje/nënndarje zonale;**

Njësia Belsh ndahet në: Belsh Qytet dhe Periferi:

Belsh Qytet do të quhen:

1. Belsh Qëndë, zona kadastrale 1147;
2. Belsh Hysë zona kadastrale 1146;
3. Gradisht, zona kadastrale 1839;
4. Trojas, zona kadastrale 3647;

Periferi do të quhen fshatrat:

1. Çepë, zona kadastrale 1367;
2. Seferan, zona kadastrale 3272;
3. Dushk, zona kadastrale 1581;
4. Marinëz, zona kadastrale 2598;
5. Shtith, zona kadastrale 3424;
6. Shkozë, zona kadastrale 3393;
7. Shkëndi, zona kadastrale 3387;
8. Stanaj, zona kadastrale 3507;
9. Qafshkall, zona kadastrale 3082;

Bëhet zbritje deri në **20%** për Njësit Administrative (Kajan, Grekan, Fierz, Rrasë) dhe **10%** zbritje për nënndarje zonale (Periferi).

A/1.1- ÇMIMET MESATARE TË NDËRTESAVE PËR BANIM

Çmimi mesatar referues për metër katror sipërfaqe ndërtimi për vlersimin e vlerës së taksueshme për banim. (zëvendësuar me VKM nr. 168, datë 27.2.2019, nr. 457, datë 26.7.2023).

1. Vlera e taksës për objekte banimi llogaritet, çmimi mesatar referues herë shkallën e taksës herë sipërfaqen e banesës, për të gjithë territorin e Bashkisë Belsh (shembull: $Vlera\ për\ m^2 = 35.000 * 0.05\% * 1m^2 = 17.5\ leqë$).
 2. Vlera e taksës për parkim të mbuluar ose bodrum llogaritet, çmimi mesatar referues herë shkallën e taksës për sipërfaqen (parkim i mbuluar ose bodrum) herë 70%. (shembull: $Vlera\ për\ m^2 = 35.000 * 0.05 * 1m^2 * 70\% = 12.25\ leqë$).
 3. Vlera e taksës për parkim të hapur llogaritet, çmimi mesatar referues herë shkallën e taksës për sipërfaqen (parkim i hapur) herë 30%. (shembull: $Vlera\ për\ m^2 = 35.000 * 0.05 * 1m^2 * 30\% = 5.25\ leqë$).
- Çmimet mesatare për ndërtesat për banim në Njësinë Administrative Belsh **qytet, Bashkinë Belsh** sipas tabelës 1.

Tabela 1.

Nr.	Lloji i pasurisë	Çmimi referues i shitblerjes së ndërtesave /leqë	Shkalla e Taksës sipas ligjit	Çmimi i ndryshuar sipas VKM	Shkalla e taksës sipas ligjit	Çmimi përfundimtar leqë/m ²
1.	Shtëpi/Apartament	35,000.00	0.05%		0.05%	17.5
2.	Parkim i mbuluar ose bodrum (0.7)	35,000.00	0.05%	70% e çmimit referues	0.05%	12.25
3.	Parkim i hapur (0.3)	35,000.00	0.05%	30% çmimit referues	0.05%	5.25
4.	Banese të privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992 (0.7)	35,000.00	0.05%	70% e çmimit referues	0.05%	12.25

- Çmimet mesatare për ndërtesat për banim në Njësinë Administrative Belsh (**Periferi**), Bashkinë Belsh bëhet zbritje 10%, sipas tabelës 2.

Tabela 2.

Nr.	Lloji i pasurisë	Çmimi referues i shitblerjes së ndërtesave /lekë	Shkalla e Taksës sipas ligjit	Çmimi i ndryshuar sipas VKM	Shkalla e taksës sipas VKB -10%	Çmimi përfundimtar lekë/m ²
1.	Shtëpi/Apartament	35,000.00	0.05%		-10%	15.75
2.	Parkim i mbuluar ose bodrum (0.7)	35,000.00	0.05%	70% e çmimit referues	-10%	11.03
3.	Parkim i hapur (0.3)	35,000.00	0.05%	30% çmimit referues	- 10%	4.725
4.	Banese të privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992 (0.7)	35,000.00	0.05%	70% e çmimit referues	-10%	11.03

- Çmimet mesatare për ndërtesat për banim në Njësitë Administrative, Bashkinë Belsh.Bëhet zbritje deri **20%**, sipas tabelës 3.

Tabela 3.

Nr.	Lloji i pasurisë	Çmimi referues i shitblerjes së ndërtesave /lekë	Shkalla eTaksës sipas ligjit	Çmimi i ndryshuar sipas VKM	Shkalla e taksës sipas VKB -20%	Çmimi përfundimtar lekë/m ²
1.	Shtëpi/Apartament	35,000.00	0.05%		-20%	14
2.	Parkim i mbuluar ose bodrum (0.7)	35,000.00	0.05%	70% e çmimit referues	-20%	9.8
3.	Parkim i hapur (0.3)	35,000.00	0.05%	30% çmimit referues	- 20%	4.2
4.	Banese të privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992 (0.7)	35,000.00	0.05%	70% e çmimit referues	-20%	9.8

A/1.2- ÇMIMET MESATARE TË NDËRTESAVE PËR VEPRIMTARI EKONOMIKE

Çmimi mesatar referues për metër katror sipërfaqe ndërtimi për vlersimin e vlerës së taksueshme për ndërtime dhe ambiente jobanimi. (zëvendësuar me VKM nr.168, datë 27.2.2019, ndryshuar shkronjat "c" dhe "ç" me vendimin nr.144, datë 13.2.2020, nr.457, datë 26.7.2023).

1. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari ekonomike tregtimi, shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më e lartë se çmimi i sipërfaqes së banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori do të përfshihen edhe njësitë tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhimi. tregtimi ose shërbime me pakicë. (shembull: $35\ 000 * 1.5 = 52\ 500 * 0.2\% = 105\ \text{lekë}$).
2. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve. (shembull: $Vlera\ për\ m^2 = 35\ 000 * 70\% * 1m^2 * 0.2\% = 49\ \text{lekë}$).
3. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ambientet parkim i hapur, pishinë e hapur, ambiente sportive të hapura, të tilla si: fusha futbollit, minifutbollit, basketbollit, volejbollit, tenisi, golfi, pista për gara të ndryshme sportive të atletikës, motorike, garave me kuaj e të tjera të ngjashme me to; porte dhe aeroporte të çdo kategorie, për të gjithë sipërfaqen e shtrirë që ato zënë, është 30 (tridhjetë) % e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve. (shembull: $Vlera\ për\ m^2 = 35.000 * 30\% * 1m^2 * 0.2\% = 21\ \text{lekë}$).
4. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industrial, të tilla si: prodhim, përpunim apo magazinim të lëndëve të para, të gjysmëprodukteve apo të produkteve të gatshme industriale, si: fabrika, depo, magazina, silos, magazina frigoriferike të produkteve ushqimore (përfshijtur ato të njësitë të tregtimit dhe të shërbimit), si dhe objekte të tjera të ngjashme me to, është 50 (pesdhjetë) % e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, sipas qyteteve. Në këtë kategori përfshihen dhe ndërtesat që shërbejnë për veprimtari arsimore jopublike të çdo niveli, si dhe ambiente sportive të mbyllura, përfshirë dhe pishinat e mbyllura. (shembull: $Vlera\ për\ m^2 = 35\ 000 * 50\% * 1m^2 * 0.2\% = 35\ \text{lekë}$).
5. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blektori, apo veprimtari mbështetëse, si: grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blektorale është 30% (tridhjetë) e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, me përjashtim të përpunimit ushqimor. (shembull: $Vlera\ për\ m^2 = 35.000 * 30\% * 1m^2 * 0.2\% = 21\ \text{lekë}$).

Shënim: Periferi do të quhen fshatrat Çepë, Seferan, Dushk, Marinz, Shtith, Shkozë, Shkëndi, Stanaj, Qafshkall.

Zbritje deri në **20%** për Njësit Administrative (Kajan, Grekan, Fierz, Rrasë) dhe **10%** zbritje për nënndarje zonale (Periferi).

- Çmimet mesatare për ndërtesat për **veprimtari ekonomike** në qytet Belsh, Bashkia Belsh, sipas tabelës 1.

Tabela 1.

Nr.	Lloji i pasuris	Çmimi referues i shitblerjes së ndërtesave /lekë	Shkalla e taksës sipas ligjit 0.2%	Çmimi i ndryshuar sipas VKM	Shkalla e taksës sipas ligjit 0.2%	Çmimi përfundimtar lekë/m ²
1.	Ndërtesa për veprimtari tregtimi shërbimi	35,000.00	0.2%	1.5 fishi I cmimit të banesave	0.2%	105
2.	Ndërtesa për veprimtari industriale , prodhim etj	35,000.00	0.2%	50 % e cmimit të banesave	0.2%	35
3.	Parkim të mbuluar dhe bodrume	35,000.00	0.2%	70 % e cmimit të banesave	0.2%	49
4.	Parkim të hapur	35,000.00	0.2%	30 % e cmimit të banesave	0.2%	21
5.	Për veprimtari bujqësore dhe blegtorale	35,000.00	0.2%	30 % e cmimit të banesave	0.2%	21

- Çmimet mesatare për ndërtesat për veprimtari ekonomike në periferi behet zbritje 10%, Bashkia Belsh, sipas tabelës 2.

Tabela 2.

Nr.	Lloji i pasuris	Çmimi referues i shitblerjes së ndërtesave /lekë	Shkalla e Taksës sipas ligjit 0.2%	Çmimi i ndryshuar sipas VKM	Shkalla e taksës sipas VKB -10%	Çmimi përfundimtar lekë/m ²
1.	Ndërtesa për veprimtari tregtimi shërbimi	35,000.00	0.2%	1.5 fishi I cmimit të banesave	-10%	94.5
2.	Ndërtesa për veprimtari industriale , prodhim etj	35,000.00	0.2%	50 % e cmimit të banesave	-10%	31.5
3.	Parkim të mbuluar dhe bodrume	35,000.00	0.2%	70 % e cmimit të banesave	-10%	44.1

4.	Parkim të hapur	35,000.00	0.2%	30 % e cmimit të banesave	-10%	18.9
5.	Për veprimtari bujqësore dhe blegtorale	35,000.00	0.2%	30 % e cmimit të banesave	-10%	18.9

- Çmimet mesatare për ndërtesat për **veprimtari ekonomike** në **Njësi Administrative**, bëhet zbritje **-20%**, Bashkia Belsh, sipas tabelës 3.

Tabela 3.

Nr.	Lloji i pasurisë	Çmimi referues i shitblerjes së ndërtesave /lekë	Shkalla e Taksës sipas ligjit 0.2%	Çmimi i ndryshuar sipas VKM	Shkalla e taksës sipas VKB 20%	Çmimi përfundimtar lekë/m²
1.	Ndërtesa për veprimtari tregtimi shërbimi	35,000.00	0.2%	1.5 fishi I cmimit të banesave	-20 %	84
2.	Ndërtesa për veprimtari industriale , prodhim etj	35,000.00	0.2%	50 % e cmimit të banesave	-20 %	28
3.	Parkim të mbuluar dhe bodrume	35,000.00	0.2%	70 % e cmimit të banesave	-20 %	39.2
4.	Parkim të hapur	35,000.00	0.2%	30 % e cmimit të banesave	-20 %	16.8
5.	Për veprimtari bujqësore dhe blegtorale	35,000.00	0.2%	30 % e cmimit të banesave	-20 %	16.8

Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme “ndërtesa” llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit.

Shënim: Perfitim ulje për **Taksa mbi ndërtesën me 5%** të gjithë bizneset që paguajn brenda datës 30 prill.

➤ **Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është:**

- Sektori i të Ardhurave Vendore për Bashkinë Belsh ngarkohet për vjeljen e taksave të biznesit të madh dhe të vogël (pagesa kryhet pranë arkës së bashkisë dhe në çdo bankë të nivelit të dytë).

- Për subjektet familje pagesa e taksës mund të bëhet çdo muaj e ndarë në 12-këste, por në mungesë të agjentit të taksave parashikuar sipas ligjit, kjo taksë do të bëhet vjetore .
- Për subjektet familje afati i pagesës është data 31.12.2025, (kjo pages bëhet pranë zyrës së Tatim Taksave Bashkia Belsh dhe në zyrat e Njësive Administrative Kajan, Grekan, Fierzë, Rrasë).
- Afati i njoftimit të tatimpaguesit do të jetë deri në datën 31.03.2025.
- Afati i pagesës së taksës së ndërtesës nga subjektet që ushtrojnë aktivitet ekonomik do të jetë data 30.06.2025.
- Për mospagesë në afatin e caktuar do të zbatohen procedurat për marrjen e masave të detyrimit tatimor sipas ligjit nr 9920, date 19.05.2008, “Per Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe do të aplikohet gjobë në masën 1.8% çdo muaj vonesë, por jo më shumë se 12 muaj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

Nr. 1874 Prot

Belsh më 23.05.2025

PROCES-VERBAL

Për

**Përlllogaritjen e kostos për pastrimin, transportin, dhe menaxhimin e mbetjeve urbane,
“organike dhe të riciklueshme” për ofrimin e shërbimit nga Sektori i Shërbimeve
Publike të Bashkisë Belsh.**

I mbajtur sot më datën2025 në prezencë të anëtareve të komisionit të ngritur me urdhërin e Titullarit të Bashkisë Belsh, me Nr. 219 Prot. datë 14 .04 .2025, në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, i përbërë nga grupi i punës :

1. Esma Zika
2. Aida Hysa
3. Vullnet Idrizi

Në zbatim të vendimit nr. 319, datë 31.5.2018 për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve, Grupi i punës nisur nga nevojat e bashkisë Belsh, për ofrimin e shërbimit nga Sektori i Shërbimeve Publike për pastrimin, transportin, dhe menaxhimin e mbetjeve urbane “organike dhe të riciklueshme”, ka llogaritur koston duke iu referuar zereva të mëposhtme:

1. Emri i Zonës së Mbetjeve (NjA)
2. INFRASTRUKTURA
 - 2.1 Tipi i kamionit
 - 2.2 Numri i kamionëve të nevojshëm
 - 2.3 Kostot totale të mirëmbajtjes
 - 2.4 Kostot e grumbullimit
 - 2.5 Kostot e transportit
 - 2.6 Kostot e shofereve dhe operatoreve
 - 2.7 Kosto totale operacionale

2.8 Total Kosto Operacionale

2.9 Kosto totale per fshirje

2.10 Totali i Kostos Sherbimit te Pastrimit

Ky procesverbal është hartuar në bazë të nevojave të Sektorit të Sherbimeve Publike të Bashkisë Belsh për menaxhimin e mbetjeve në territorin e kësaj bashkie, duke iu referuar zerave të sherbimeve për pastrimin, transportin, dhe menaxhimin e mbetjeve urbane "organike dhe të riciklueshme" që do të ofroje ky sektor për një periudhë 12 mujore.

Bashkëlidhur do të gjeni preventivin për llogaritjen e kostos!

Grupi I Punës

1. Esma Zika

2. Aida Hysa

3. Vullnet Idrizi

KRYETARI I BASHKISË

Arif Tafani

(Në Mungesë dhe me Urdhër)

Sekretari i Përgjithshëm

Mustafa ÇARÇIU



Perillogarja e koston per pastrimin, transportin, dhe menaxhimin e mbetjeve urbane, "organike dhe B rikikueshme" per ofrimin e sherbimit nga Sektori i Sherbimeve Publike te Bashkise Belesh, per perulidhen 12 mujore

TE DHENAT BAZE								TOTALI KOSTOS LEKE VITI 2025
Nizones se Mbetjeve (NJA)	Njësia	Belesh Urban	Kajani	Fierz	Rrasë	Grekani	Belesh Rural	
kuencia e grumbullimit te mbetjeve	Nr	6	1	1	1	1	2	
Ullisja dhe biznesi shërbyer ne kete zone	Nr	Urban	rural	Rural	Rural	Rural	Rural	
popullsia qe perjashket (te regjistruar, por jetojne jashte)	Nr	2,148	3,349	2,053	1,062	2,857	5,654	17,123
ullisja shërbyer (me konsiderohet për shërbimin)	%							
et (distanca nga Landfilli, varite ardhje)	Nr	2,148	3,349	2,053	1,062	2,857	5,654	17,123
et (distanca e përkuar gate grumbullimit, turn për një kamion)	Km	60	60	60	60	60	1	301
et e gjenetara pr njes (bande, biznes, institucion)	Km	6	52	49	17	49	39	210
mbetjeve te gjenetara	kg/njese/dite	1,288.8	1,544.6	946.8	489.8	1,317.6	2,607.6	8,195
mbetjeve te gjenetara	ton/dite	1.3	2	0.9	0.5	1.3	2.6	8
mbetjeve te gjenetara	ton/dite	1.3	1.1	0.9	0.49	1.3	2.6	8
mbetjeve te gjenetara	ton/jave	10	10	10	10	10	10	10
mbetjeve te gjenetara	ton/vit	469	552	445	176	460	449	2,963
INFRASTRUKTURA								
kamioni	ton	10	10	10	10	10	10	
ari i mbushjes se kamioni (%)	%	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	
cite i mbushjes i kamioni (85% kapaciteti mbushjes)	ton	8.5	8.5	8.5	8.5	8.5	8.5	
per numrin e turneve dhe kamioneve qe nevojiten	numri	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	1.00	
turneve per kamion ne dite	turne/dite	1	1	1	1	1	1	
numri	numri	1	1	1	1	1	1	
enleri i mbetjeve	numri	Kazan	Kazan	Kazan	Kazan	Kazan	Kazan	
kazanili	m3	1.1	1.1	1.1	1.1	1.1	1.1	
e e mbetjeve ne ne kazan	ton	0.117	0.117	0.117	0.117	0.117	0.117	
te gese ekstra identifikim ose nevojia shites	numri	0	0	0	0	0	0	
te gese ekstra identifikim ose nevojia shites	numri	0	0	0	0	0	0	
KOSTOJE E MIREMBALJES								
mi i kamionit + taksa	leke/kamion/vit	400,000	-	-	-	-	-	
filtr	leke/kamion/vit	250,000	-	-	-	-	-	
leke/kamion/vit	leke/kamion/vit	200,000	-	-	-	-	-	
mbalje mekanike	leke/kamion/vit	100,000	-	-	-	-	-	
7	leke/kamion/vit	50,000	-	-	-	-	-	
KOSTOJE E MIREMBALJES								
leke/kamion/vit	leke/kamion/vit	1,000,000	-	-	-	-	-	1,000,000
TOTALI KOSTOS LEKE VITI 2025								
te grumbullimit	Njësia	Belesh	Kajani	Fierz	Rrasë	Grekani	Belesh rural	
one nrese me pak se 2ton/dite, grumbullim 2zherë/ave	dite	310	52	52	52	52	52	570
te e karburanti	leke/liter	170	170	170	170	170	170	1,020
se te ngarkuar ne kamion ne here - koha e grumbullimit	ore	4	4	4	4	4	4	24
otale per grumbullim (n: kamioneve * kohë/kamion * nr. i turneve)	ore/dite	1	1	1	1	1	1	5
per te sharkuar ne landfill (n)	ore	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5	3
roni i kohes totale per grumbullim (%)	%	83%	83%	83%	83%	83%	83%	5
ranti i konsumuar gate grumbullimit	litra/vit/ 12 muaj	110,670.0	159,341.0	151,606.0	51,051.0	150,577.8	119,119.0	742,465
stra rruge (vit ne total per grumbullim	km/vit/ 12 muaj	1,860.0	2,678.0	2,548.0	858.0	2,532.4	2,002.0	12,478
te totale per grumbullim (le)	leke/vit	110,670	159,341	151,606	51,051	150,578	119,119	742,465
TOTALI KOSTOS LEKE VITI 2025								
te transportit	Njësia	Belesh	Kajani	Fierz	Rrasë	Grekani	Belesh rural	
esia e lrvizet	km/ore	50	50	50	50	50	50	50
transportimi per ne landfill	ore	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5
otale e harxhuar per transportim (nje dite/te gjithë kamionet)	ore/dite	0.8	0.8	0.8	0.8	0.8	0.8	0.8
cioni i kohes totale per transport (%)	%	17%	17%	17%	17%	17%	17%	17%
km per transport per dit, te gjithë kamionet	km/dite	66.0	111.5	109.0	76.5	108.7	39.5	511.2
an i konsumuar gate transportit	litra/vit/	948,600.0	159,120.0	159,120.0	159,120.0	159,120.0	2,652.0	1,587,732.0
tra rruge (vit ne total per transport	km/vit/	18,600	3,120	3,120	3,120	3,120	52	31,132.0
te totale per transport (le)	leke/vit	948,600	159,120	159,120	159,120	159,120	2,652	1,687,732
TOTALI KOSTOS LEKE VITI 2025								
te shofereve dhe operatorëve	Njësia	Belesh	Kajani	Fierz	Rrasë	Grekani	Belesh rural	
punes ne jave	dite/ave	6	1	1			1	
punes ne jave	ore/ave	40	40	40			40	
punes ne dite	ore/dite	8	8	8			8	
balja (ne % nda kohes së punës)	%	7.30%						
net	%	7.70%						
i shoferave bazuar ne nevojën diore (duke marrë ne konsiderate net sipas turneve = nuk mund te ndërrohen shoferët ne mes të turnit)	1							
punes per jave / shofer (pa mirembaljen dhe fundjave)	ore	33.9	33.9	33.9			33.9	
avore e nevojshme per mirembalje	ore/ave	2.47	2.47	2.47			2.47	
avore e nevojshme per pushim fundjave	ore/ave	2.61	2.61	2.61			2.61	
punes per jave / shofer (me mirembaljen)	ore/ave	36.3	36.3	36.3			36.3	
total i shoferave te nevojshëm (duke konsideruar oret maksimale të punës 8)	numri	2	0	0			0	
mujore e shoferave	leke/vit	672,192	-	-			-	
(ne % nda pages)	%							
te shoferave	leke/vit	1,344,384	-	-			-	1,344,384
i punonjësve operatorëve per eksp (1 shofer X 2 operatorë)	numri	4	0	0			0	
punes ne jave/operator (përshijne mirembaljen)	ore/ave	28.0	0	0			0	
i mbetur per detyra te tjera ne jave / operator	ore/ave	11.9	0	0			0	
mujore e punonjësve/operatorëve	leke/vit	560,160	0	0			0	
(ne % nda pages)	%		0	0			0	
te totale per operatorëve	leke/vit	2,240,640	-	-			-	2,240,640
TOTALI KOSTOS LEKE VITI 2025								
te amortizimit	Njësia	Belesh	Kajani	Fierz	Rrasë	Grekani	Belesh Rural	
te	%/vit	0%	0%	0%			0%	
amortizimi per kamionet	leke/vit	-	-	-			-	
te	%/vit	-	-	-			-	
amortizimi konteniere	leke/vit	-	-	-			-	
te totale per amortizimit	leke/vit	-	-	-			-	

Kosto totale operacionale	Njësia	Belsh	Kajon	Fierz	Rrasë	Grëkan	Belsh Rural	TOTALI
Mirembajtje	Leke/vit	5,644,294	318,461	310,726	210,171	309,798	121,771	6,915,221
Kosto totale investime	Njësia	Belsh	Kajon	Fierz	Rrasë	Grëkan	Belsh Rural	TOTALI
Kamione/bleje/qera	Leke							
Kontener	Leke							
Kosto totale	%	20%	20%	20%	20%	20%	20%	
(ne % ndaj koston totale shpenzime kostoje TVSH)	Leke/vit	1,128,859	63,692	62,145	42,034	61,960	24,354	1,383,044
Totali i të ardhurave neto	Leke/vit	6,773,153	382,153	372,871	252,205	371,757	146,125	8,298,265
TOTAL KOSTO OPERACIONALE	Leke/vit							5,498,880
Kosto totale për fshite	Leke/vit							
Kosto totale për lartje	Leke/vit							
TOTALI I KOSTOS SHËRBIMIT TE PASTRIMIT	Leke/vit							13,157,545
Kostot totale për ton mbetje (çikël i plotë)	Leke/ton	14,438	880	1,082	1,415	775	154	2,782
Kostot totale për banor mbetje në vit (çikël i plotë)	Leke/banor/vit	3,153	114	182	237	130	26	485
Kostot totale për banor shërbim pastrimi në vit (çikël i plotë)	Leke/banor/vit							805.8

Struktura e koston se shërbimit te pastrimit	%	Leke në vit
Afrembajtje	7%	1,000,000
Grumbullim	5%	742,465
Transport	12%	1,587,732
Ershetimi	58%	8,066,304
Investimi	0%	
Shpenzime administrative	10%	1,388,044
Shfite	7%	1,012,600
Shfite	0%	
TOTALI	100%	13,797,145
KOSTO TOTALE PER GRUMBULLIMIN DHE TRANSPORTIN E MBETJEVE	1	13,797,145

erlogaritja e koston eshte hartuar ne zbatim te vendim nr. 315, datë 31.5.2018 për miratimin e masave për koston e menaxhimit të integruar të mbetjeve

PERGATITI:

Esma Zika

Aida Hysa

Vullnet Idrizi

MIRATOL:
KRYETARI I BAKISE BELSH
ARIF TAFANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH

Nr. ____ Prot.

Belsh, më: ____/____/2025

PROJEKT – VENDIM
PER MIRATIMIN E KOSTOS SE PERLLOGARITUR PER ZBATIMIN E TIJ

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.6(b), nenit 23, pika 10, nenit 33, pika 1(d) dhe nenit 54, pika (d) të ligjit të ligjit nr.139/2015 " Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar, Ligji Nr.10463 date 22/09/2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve" .ligjin Nr.10431 datw 09.06.2011 "Pwr mbrojtjen e mjedisit"

PROPOZOJMË

1. Miratimin e Kostos totale te përllogaritur për pastrimin, transportin dhe menaxhimin e mbetjeve urbane , "organike dhe te reciklueshme" per periudhe 12 mujore per vitin 2025-2026.
2. Kostoja se perllogaritur do te monitorohet nga Bashkia Belsh, ne perputhje me kuadrin ligjor.

Ju faleminderit!

Përgjegjese Shërbimeve

Ramadan Cekrezi

Konceptoi Bazën ligjore

Sheje Ndoni

Drejtor I Shërbimeve

Andon Xhafa

KRYETARI I BASHKISË

ARIF TAFANI

(në mungesë dhe me përfaqësim)

Sekretari Përgjigjedem)

Mustafa CARÇIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

Belsh, më: ____/____/2025

Lënda: **RELACION**

KËSHILLIT BASHKIAK BELSH

Të nderuar këshilltarë!

Ne mbështetje të projekt-vendimit për Miratimi e Kostos së përlllogaritur për zbatimin e tij”

Baza Ligjore e projekt-vendimit;

Ky projekt-vendim mbështetet në nenin 7,pika 2; nenin 8 ,pika 2; nenin1(6)(b);NENIN 23,PIKA 10;nenin 33,pika 1(d) dhe nenin 54,pika(d) të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore” të ndryshuar.

Arsyetimi:

Kostos totale të përlllogaritur për pastrimin, transportin dhe menaxhimin e mbetjeve urbane , “organike dhe të reciklueshme” për periudhë 12 muaj për vitin 2025-2026 synon të garantojë një shërbim të specializuar, të kontrolluar dhe të qëndrueshëm për komunitetin. Menaxhimi i mbetjeve urbane përben një nga sfidat kryesore për njësitë e qeverisjes vendore. Bashkia Belsh gjithashtu synon të organizojë dhe përmisojë shërbimet e pastrimit dhe grumbullimit të mbetjeve në përputhje me standartet mjedisore.

Perfitimet:

- Rritja e Efikasitetit në menaxhimin e mbetjeve .
- Reduktim i ndotjes mjedisore.
- Rritja e cilësisë së jetesës për komunitetin.
- Përshtatjen me kërkesat e legjislacionit kombëtar dhe të BE-së

Kostoja totale e përlllogaritur për pastrimin, transportin dhe menaxhimin e mbetjeve urbane , “organike dhe të reciklueshme” për periudhë 12 muaj është 13 797 145 lekë.

Bashkangjitur do të keni proceverbalin e mbajtur nga komisioni I ngritur per perlllogaritjen e Kostos.

Përgjegjese Shërbimeve

Ramadan Cekrezi 

Konceptoi Bazën ligjore

Sheje Ndoni 

Drejtore I Shërbimeve

Andon Xhafa





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Datë: 16.06.2025

Kërkesë

Drejtuar: Kryetarit të Këshillit Bashkiak Belsh

Këshillit Bashkiak Belsh

Unë i nënshkruari Aleksandër Peqini, lindur më 24.07.1994 në Belsh, për shkak të angazhimeve akademike në Gjermani,

kërkoj që të dorëhiqem dhe të dorëzoj mandatin e *Këshilltarit Bashkiak të Bashkisë Belsh*.

Kërkoj nga ana e Këshillit Bashkiak Belsh, miratimin e kësaj kërkesë.

Faleminderit për mirëkuptimin!

Punë të mbarë!

Këshilltari

Aleksandër PEQINI